



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Korçë, më 13.09.2023

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

(paraparak)

Date 13.09.2023

Drejtuar: *Shoqeria "INSTANT.AL" shpk adresa : Tirane, Rruga Idriz Dollaku, Ali demi, Apartamenti 2, shkalla 1, kati i pare.*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF- 77745-08-17-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **"Loti 1-Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj)"**

Afati: **30 ditë kalendarike nga data e lidhjes te kontrates**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Date 21.08.2023, Nr.70**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Shoqeria "EURO INFORM" shpk, NIPT K33721008C me vleren:**

*2.446.800 (dy milion e katerqind e dyzet e gjashte mije e teteqind) lekë, pa tvsh.*

**2 Shoqeria "INSTANT.AL" shpk, NIPT L81506043D me vlerën:**

*2.498.900 ( dy milion e katerqind e nentedhjete e tete mije e nenteqind ) lekë pa tvsh.*

**3. Shoqeria "DIVITECH" shpk, NIPT L01306049O me vleren:**

*2.590.600 (dy milion e peseqind e nentedhjete mije e gjashteqind ) lekë pa tvsh.*

Nga pjesërmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. Shoqëria “ EURO INFORM ” shpk, NIPT K33721008C per arsye se;**

Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, **pika 2.3.2** Për të vertetuar se përmbush specifikimet e kërkuara Operatori Ekonomik duhet te paraqese katalogun teknik ose skedat teknike te produkteve te kerkuara.

*Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

Konkretisht në katalogët e dorezuar nga ofertuesi mungojnë pajisjet e mëposhtme:

RAM Workstation 8GB DDR IV

SSD 960 GB

SSD 240 GB

RAM Pc zyre I5 DDR III 4GB

Drum all color HP 880 MFP

Furre HP 880 MFP

Suport Projektori

**2. Shoqëria “ DIVITECH ” shpk, NIPT L013060490 per arsye se;**

1.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 1.a dhe pika 1.b ku përcaktohet se:

*“Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Konkretisht ofertuesi nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe nuk ka paraqitur as sigurimin e ofertes.

2. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.3.1 ku përcaktohet se *“Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur Çertifikaten ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise” ose ekuivalente.”*

Konkretisht ofertuesi nuk ka paraqitur Çertifikate ISO 9001: 2015.

3. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.3.2 Për të vertetuar se përmbush specifikimet e kërkuara Operatori Ekonomik duhet te paraqese katalogun teknik ose skedat teknike te produkteve te kerkuara.

*Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

Konkretisht ofertuesi nuk ka paraqitur kataloge ose skeda teknike te produkteve te kerkuara.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“INSTANT.AL ”sh.p.k me adresë: Tirane, Rruga Idriz Dollaku, Ali demi, Apartamenti 2, shkalla 1, kati i pare,** se oferta e

paraqitur me vlerë totale prej **2.498.900** ( *dy milion e katerqind e nentedhete e tete mijë e nëntëqind* ) *lekë pa tvsh* është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
SOTIRAQ FILO**